



**Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ e Kosovës  
Savez Sportsko Recreativnih Ribolovaca Kosova  
Kosovo Federation of Sports Recreational Fishermen**

**RREGULLORE NR. 4 / 2024 RREGULLOREN MBI PUNËN E KËSHILLIT  
MBIKQYRËS TË KUVENDIT TË FEDERATES SË PESHKATARVE  
SPORTIV REKREATIV TË KOSOVËS**

Prishtine korrik 2024

Në përputhje me nenin 19 të Statutit të **Federata e Peshkatarëve Sportiv Rekreativ e Kosovës**, Bordi i FPSRK-së me datë ..... PROPOZOJ këtë:

## **RREGULLOREN MBI PUNËN E KËSHILLIT MBIKQYRËS TË KUVENDIT TË FEDERATES SË PESHKATARVE SPORTIV REKREATIV TË KOSOVËS DISPOZITAT THEMELORE**

### **Neni 1**

Këshilli Mbikëqyrës kujdeset për punën, ligjshmërinë dhe për veprimtarinë materialo – financiare të FPSRK-së. Këshilli mbikëqyrës e ka Kryetarin dhe dy anëtarët të cilët zgjidhen nga anëtarësia e FPSRK-së, të cilët nuk janë anëtarë të Kuvendit, por duhet të jenë njohës të sportit për shkak të natyrës së punës.

Me këtë rregullore po ashtu rregullohet edhe mënyra e punës Këshillit Mbikëqyrës të Kuvendit të Federatës së Peshkatarë Sportiv Rekreativ të Kosovës (tutje referuar si “Këshilli Mbikëqyrës”).

### **Neni 2**

Këshilli Mbikëqyrës punon në bazë të parimit të ligjshmërisë, të efikasitetit dhe ekonomicitetit. Mbikëqyrë, shqyrton aktet juridike, vendimet e ndryshme dhe punën materialo – financiare të FPSRK-së.

### **Neni 3**

Sipas dispozitave të kësaj rregulloreje përgatiten, caktohen dhe mbahen mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të Kuvendit të Federatës së Peshkatarë Sportiv Rekreativ të Kosovës dhe realizohen autorizimet dhe obligimet e tij.

### **Neni 4**

Këshillit Mbikëqyrës të Kuvendit të Federatës së Peshkatarë Sportiv Rekreativ të Kosovës përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, ekspertë të fushave të caktuara, të cilët i zgjedh Kuvendi. Këshilli tre (3) anëtarësh vendosë me shumicë votash për vendimet e tij dhe përpilon raportin me shkrim.

Vendimet, raportet dhe aktet tjera të Këshillit Mbikëqyrës ruhen si dokumentacion zyrtar në arkivin e FPSRK-së.

Këshilli Mbikëqyrës për punën e vet informon Bordin e FPSRK-së dhe për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të FPSRK-së.

Anëtarët e Këshillit i zgjedhë dhe i shkarkon Kuvendi i FPSRK-së.

### **Neni 5**

1. Mandati i anëtarëve të Këshillit zgjatë 4 (katër) vite me mundësi vazhdimi edhe për 1 (një) mandat

2. Mandati i anëtarëve të Këshillit mund të pushoi edhe para skadimit të mandatit në këto rastet e më poshtme:
  - a. dorëheqja e anëtarit të Këshillit;
  - b. shkarkimi i tij;
  - c. shpartallimi i organizatës;
  - d. vdekja;
  - e. në raste tjera të parapara në Ligj dhe Statut.
3. Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës ka të drejtat dhe detyrat si vijon:
  - a. Organizon dhe konvokon mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës
  - b. Kryeson me mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës
  - c. Kujdeset për sigurimin e transparencës në punën e Këshillit Mbikëqyrës
  - d. Kryen edhe detyra të tjera të caktuara me Rregulloren mbi Punën e Këshillit Mbikëqyrës.

## **FUSHËVEPRIMI**

### **Neni 6**

1. Fushëveprimi i Këshillit Mbikëqyrës të Këshillit Mbikëqyrës të Kuvendit të Federatës së Peshkatarë Sportiv Rekreativ të Kosovës është:
  - a. mbikëqyrja e zbatimit të Statutit dhe të akteve të tjera normative;
  - b. mbikëqyrja e gjendjes materialo-financiare;
  - c. mbikëqyrja e shfrytëzimit të pasurisë së Federatës;
  - d. mbikëqyrë zbatimin e Vendimeve, Konkluzave dhe akteve të tjera juridike;
  - e. kryen edhe punë tjera që ia beson Kuvendi.

## **MBLEDHJET E KËSHILLIT MBIKËQYRËS (KM)**

### **Neni 7**

Këshillit Mbikëqyrës të Kuvendit të Federatës së Peshkatarë Sportiv Rekreativ të Kosovës në mbledhjet e veta nxjerr Vendime, Konkluzione, Qëndrime, jep mendime, nis iniciativa dhe propozon zgjidhje të përshtatshme.

### **Neni 8**

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të FPSRK-së mbahen sipas nevojës.

### **Neni 9**

Në mbledhjet e Këshillit mbahet procesverbali. Procesverbali duhet të mbahet në mënyrë korrekte, ku secilit anëtar mund të i lexohet diskutimi i tij nëse e kërkon ai. Procesverbalin e nënshkruan Procesmbajtësi dhe Kryetari.

### **Neni 10**

Mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës e thërret Kryetari.

### **Neni 11**

Për mbledhje të Këshillit ftohen gjithmonë të gjithë anëtarët.

### **Neni 12**

Prania në mbledhje është e obligueshme. Nëse ndonjëri prej anëtarëve ka pengesa për ardhje në mbledhje, ai ka për obligim që ta njoftoi Kryetarin.

## **PUNA NË MBLEDHJET E KËSHILLIT MBIKQYRËS**

### **Neni 13**

Këshilli Mbikëqyrës i FPSRK-së punon dhe vendos në mënyrë të plotfuqishme nëse në mbledhje prezantojnë të gjithë anëtarët.

### **Neni 14**

Për secilën pike të rendit të ditës bëhet shqyrtim i veçantë dhe sipas radhitjes së miratuar.

## **VENDIMET DHE VOTIMI**

### **Neni 15**

Vendimet e Këshillit miratohen me shumicën e votave të anëtarëve.

## **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 16**

Punët administrativo-teknike për nevojat e Këshillit Mbikëqyrës i bën Sekretari i Organizatës.

### **Neni 17**

Kjo Rregullore hyn në fuqi, shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i **Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ e Kosovës** dhe publikimit në faqen zyrtare të FPSRK-së.



Milaim Viti

Kryetar i Federata e Peshkatarëve Sportiv Recreativ e Kosovës